REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 61/17
Datë/Datum. 28.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

"BOTEK" Sh. P. K. Prishtinë

Nr. i AP: ____ MASHT208-17-001-1-1-1_____
(shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Kundër vendimit të autoritetit kontraktues për eliminimin e kompanisë tonë lidhur me tenderin:
Furnizim me teknologji informative per nevojat e Masht_it
(shëno titullin e kontratës si në paragrafin II..1 të Dosjes së Tenderit)

të iniciuar nga
_ Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë_
(shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)
në afatin ligjor parashtroj këtë:

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit
"BOTEK" sh. p. k.

(shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Agim Ramadani Akt .1. objekt c

(Adresa) *10000*
Prishtinë
(Vendi) *(Kodi Postal)*
038/245-830 *038/245-625*
(Numri i telefonit) *(Numri i faksit)*

Hilmi Asllani
(emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@bo-tek.com
(adresa elektronike)

28.02.2017
(data e parashtrimit të ankesës) *(nënshkrimi dhe vula)*

IT Communication · Energy
BOTEK sh.p.k.
2003 Prishtinë, Republika e Kosovës 2015

***Ankues mund të jetë pala e interesuar (operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit).*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(emri i avokatit)

_____

(adresa e plotë)

_____ _____

(numri i telefonit) *(numri i faksit)*

_____

(adresa elektronike)

_____ _____

(data e parashtrimit të ankesës) *(nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Një përshkrim i shkurtër lidhur me datën dhe emrin e gazetës (ve) ditore në të cilën (at) është publikuar " Njoftimi për Kontratë" si dhe "Njoftimi për dhënie të Kontratës", afati i fundit për dorëzimin e tenderit, data dhe ora e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Data e njoftimit për kontrate: 31.01.2017
Data e dorëzimit të tenderit: 01.03.2017
Kriteri për dhënie te kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po ☐ **Jo** ☒

Ne me date 21 Shkurt, 2017 kemi bere kërkesën tonë për rishqyrtim pranë AK (Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë).

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë e gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës:

1.) LPP Neni 28. Specifikimet teknike - pika 2 dhe pika 7.
2.) Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

*** Sipas nenit 113 të LPP-së, OSHP-ja do të konfiskoj Sigurimin e Ankesës tuaj, nëse Paneli Shqyrtues konstaton se të gjitha apo cilado nga pretendimet e bëra në ankesë kanë qenë të rrejshme apo mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne me 21 Shkurt, 2017 kemi bere kërkesën tonë për rishqyrtim pranë AK (Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë). (DOKUMENTI 1)
Me date 27 Shkurt, 2017 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga MASHT (DOKUMENTI 2). Ne ketë shkrese na është shpjeguar se kinse "AK paska bere specifikimin e pajisjeve ne mënyre te përgjithësuar/bazuar ne kërkesat dhe nevojat e institucionit", informata te cilat janë plotësisht te pavërteta dhe te sqaruara me poshtë.

Sa i përket pjesës ku thuhet se kërkesat janë të pergaditura nga AK për nevoja te tyre, fillimisht duhet theksuar se është e pa-vërtete pasi qe shume qarte shihet(Screenshot) dokumenti i dosjes se tenderit (SPECIFIKACIONI TEKNIK) është i punuar nga personi i caktuar i punësuar tek distributori i këtyre pajisjeve .(DOKUMENTI 3). Kjo i lidhje e drejte-përdrejte te zyrtareve te prokurimit dhe personave te caktuar nga distributori lokal qe ka te beje me parapërgatitjen dhe kurdisjen e specifikacionit teknik për ketë procedure te prokurimit me qellim te favorizimit te prodhuesve/kompanive te caktuara.

Pra, në dosjen e tenderit janë kërkuar **40 produkte te IT**-se kur për **13 prej tyre është kërkuar Autorizimi i** prodhuesit, Deklarata e prodhuesit për garancinë si dhe Deklarata e prodhuesit qe modelet e ofertuara të pajisjeve të jenë të reja dhe aktuale.

Me një rishikim të thjesht (Kërkim në Google) mund të shihet qarte që specifikimet janë përpiluar 100% për prodhues te caktuar dhe nuk mund te plotësohen nga prodhues tjerë !!!

Pas kontakteve me këta prodhues ne jemi njoftuar se ***"projekti është shkruar dhe bllokuar nga një distributor i caktuar lokal"*** (për të cilën ne posedojmë fakte të qarta) dhe ***"nuk mund te na dërgojnë çmimet dhe dokumentet e kërkuara".***

Në vazhdim po i listojmë si (PROVA 1-13) Produktet për të cilat specifikimi teknik në DT është i kopjuar 100 % nga broshurat e prodhuesve të caktuar si ; Lenovo, Lexmark, Digitus, APC, Epson dhe Konica.

Nr. ne dosje	Produkti i kerkuar	Modeli	Prova
1	Brand Name Desktop PC	Lenovo ThinkCentre M700	1
2	Brand Name Monitor	Lenovo ThinkVision E2224	2
3	KVM SWITCH - 4 port	Digitus DS-12402	3
4	Brand Name Laptop	Lenovo ThinkPad E570	4
9	Brand Name Printer	Lexmark MS312dn	5
10	UPS 1000VA per montim ne rack	APC SMC1000I-2U	6
11	Brand Name Multifunction Color Laser Printer	Lexmark CX510de	7
12	UPS 1400 VA	APC SMC1500I-2U	8
16	UPS 950VA (brand)	APC BX950UI	9
17	Brand Name Printer Laser Color	Lexmark CS410dtn	10
19	Brand Name Scanner	Epson Perfection V600	11
20	Brand Name Projector	Epson EB-S31	12
24	Brand Name - Fotokopje e madhe	Bizhub C308	13

Këtu shihet qarte se saktësisht specifikimet teknike ja të kopjuara **100%** nga këto broshura dhe të përshkruara në Dosjen e tenderit.

Duke u bazuar në këto faktet e lartpërmendura ju si AK keni bere shkeljet e **LPP-se** dhe më konkretisht neneve si ne vijim:

Neni 28. Specifikimet teknike pika 2. *Citat nga kjo pikë: "Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik."*

Neni 28. Specifikimet teknike pika 7. *Citat nga kjo pikë: "Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi"*

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Ndërsa, sa i përket arsyetimit se MAF duhet te dorëzohet për të vërtetuar se pajisjet janë te reja nuk është e vërtete. Pajisjet janë obligim te dorëzohen te reja dhe kompanitë e mbajnë përgjegjësin me ane te deklaratave te nënshkruara. Po ashtu bazuar ne praktikat e deritashme DAF (Distributor Authoriaztion Form) është me se i mjaftuar për te vërtetuar cilësinë e produkteve. Prandaj, kërkojmë nga ju qe te detyroni AK te ndryshoje ketë kërkese dhe autorizimi nga Distributori te kërkohet për pajisjet kryesore te kësaj DT.

Prandaj vetëm një ndryshim rrënjësor i këtyre specifikime teknike dhe kërkesave tjera (si .psh. Autorizimet nga MAF ne DAF) në përputhje me LPP e mundëson pjesëmarrjen e më shumë prodhuesve si dhe kompanive në këtë tender.

Rrjedhimisht duke i marrë për bazë të gjitha këto mangësi të shumta në formën ekzistuese në këtë Dosje të Tenderit, cilat përbejnë shkelje të qarta Ligjore, kërkojmë nga ju qe te bëni ANULIMIN e kësaj Procedure të Prokurimit me qëllim të Riformulimit të Specifikimeve Teknike si dhe të dokumenteve të kërkuara (nga MAF në DAF) komform LPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Nga humbja e kësaj kontrate kompania jone humb fitime financiare.

9. Propozim

Ofroni, nëse është e mundur propozimin tuaj për hapat e mëtutjeshëm në lidhje me këtë aktivitet të prokurimi:

- Anulimi i kontratës dhe ri-tenderimi me specifikacionet komform LPP-së.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Regjistroni secilën dëshmi të cilën do t'i bashkëngjitni ankesës tuaj. Në mënyrë që ankesa juaj të merret në shqyrtim, duhet të ketë të bashkangjitur patjetër ***Publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës*** *me të cilën do të dëshmohet data si dhe emri i gazetës në të cilën është publikuar ky njoftim apo njoftimin e kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar, procesverbalin e hapjes publike të tenderëve, si dhe të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

1. Deklarata mbi faktet dhe argumentet dhe provat përkatëse.
2. FTD
3. Vendimin për refuzimin e ankesës për rishqyrtim.
4. Flete pagesa

*** Sipas nenit 106.2 të LPP-së, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës në fjalë, do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe më pas një kopje të protokolluar nga OSHP-ja do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*